



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPJAN/ MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATË

Date: 30/03/2020

Në mes të

Komuna e Lipjanit – Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues) dhe

Kontraktuesi “VIVA Fly” shpk përfaqësuar nga Avdyl Rexhepi, me numër të regjistrimit të biznesit..81086238 në tekstin e mëtejme (“Kontraktuesi”), janë pajtuar të lidhin këtë kontratë:

Llot 1 Furnizimi me artikuj ushqimor dhe material higjenik me nr. të prokurimit 613 020 006 525,

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontraktuesi do të furnizojë me artikuj të ndryshëm ushqimor dhe aterial higjenik të përshkruara në tabelën e poshtëshënuar.

1	Vaj 900 ml	copë	4500	0.95	4275.00
2	Sheqer paketim 5 kg	copë	500	3.00	1500.00
3	Kryp	kg	1500	0.26	390.00
4	Qumshtë 1l	litër	3000	0.75	2250.00
5	Makarona 450 gr	copë	2000	0.52	1040.00
6	Pasul 600 gr	copë	3000	1.50	4500.00
7	Oriz Paketim 800 gr	copë	3000	0.85	2550.00
8	Fide 500 gr	copë	2000	0.45	900.00
9	Biber 400 gr	copë	500	1.99	995.00
10	Vegetë 500 gr	copë	500	0.80	400.00
11	Çaj 400 gr	copë	1000	2.70	2700.00
12	Narezak 200 gr	copë	2500	0.65	1625.00
13	Patate paketim 10 kg	copë	500	2.70	1350.00

14	Detergjent 3 kg	copë	500	1.99	995.00
15	Shampon për flok 1 l	copë	500	0.75	375.00
16	Sampon për enë 640 ml	copë	500	0.65	325.00
17	Demostos 750 ml	copë	500	1.19	595.00
18	Sapun për duar	copë	1000	0.20	200.00
19	Shampon për duar 1l	copë	500	0.80	400.00
20	Dorza Higjenike	copë	3000	0.07	210.00
21	Maska (mbrojtse)	copë	4000	0.65	2600.00
	RIKAPITULLIM				30175.00

Neni 2 Vendi i dorëzimit

Kontraktuesi do të furnizojë me artikujt e përshkruar sipas nevojës dmthpër një pjesë do të pranojë listen e përfitueve të donacionit dhe në bashkëpunim me menaxherin e caktuar do ta dorzojë drejtpërdrejt te përfituesi, pjesa tjetër do të deponohet në depo të komunës e cila caktohet nga menaxherët e kontratës respektivisht në depon te shkolla bujqësore në Lipjan.

Neni 3. Hyrja ne fuqi e kontratës

Kontrata hynë në fuqi me nenshkrim respektivisht 30/03/2020 dhe përfundon me 20/04/2020 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se **maksimumi 20 ditë** nga data e marrjes së urdhëreses.

Neni 4 Çmimi i kontratës

Çmimi i furnizimeve sipas kontratës me procedurë të negociuar është gjithsej: **30175€** ose shprehur me fjalë tridhjetëmijë e njëqind e shtadhjet e pesë sipas përshkrimeve të sasive të dhëna ne Dosjen e tenderit nr. 613-020-006-525 .

Neni 5 Pagesat

Pagesa do të bëhet në Euro. Pas përfundimit të furnizimeve dha hartimit të raporti nga komisioni për pranim të mallit do të kryhet pagesa.

Faturat do të krijohen sipas zotimit të mjeteve , për hartim te faturave kontraktuesi do të konsultohet me menagjerët e kontratës.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 6 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 7 Kualiteti

Kualiteti mallrave të furnizuar duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [*të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet*] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon

ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *furnizimeve* të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

Autoriteti kontraktues do të inspektojë, kontrollojë, mallrat e furnizuara në momentin e pranimit të artikujve ushqimor dhe materialit higjenik të dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse mallrat e furnizuara kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Falimenton; e). f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 80 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 12 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [*specifiko gjykatën kompetente*] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 13 Komunikimi

Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [*Shqip*] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Avdyl Rexhepi	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	30.03.2020	Data:	
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

ZYRA E KRYETARIT

Konform nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, neni 61 pika 61.4 të Rregullave dhe Udhëzues Operativ për Prokurimin Publik dhe Statutit të Komunës së Lipjanit neni 41, Kryetari i Komunës, më: 30/032020 merr këtë vendim:

V E N D I M

Për caktimin e organit për mbikëqyrje profesionale të furnizimeve

Me këtë vendim caktohet organi për mbikëqyrje profesionale. Ky organ është caktuar duke pas parasysh specifikat e projektit, sipas kontratës “**Furnizimi me artikuj ushqimor dhe material higjenik** me numër identifikues: 613-20-006-525

I. Organi mbikëqyrës caktohet:

Rexhep Zejnullahu- kryetar

Ismet Haziri – anëtar

Ramush Shala –anëtar

Organi mbikëqyrës, ka për detyrë të mbikëqyrë në mënyrë profesionale për furnizimin sipas kontratës **Furnizimi me artikuj ushqimor dhe material higjenik** me numër identifikues: 613-20-006-525

Obligimet bazë të organit mbikëqyrës do të jenë:

Që të bëjnë mbikëqyrjen e realizimit të projektit për Furnizimi me artikuj ushqimor dhe material higjenik me numër identifikues: 613-20-006-525

Të përfaqësojnë interesin e K Lipjan gjatë furnizimeve sipas kontratës së lartshënuar dhe të vlerësojë realizimin e furnizimeve nga ana e kontraktuesi dhe të arrijë synimet siç janë:

- a) Të sigurojnë se pozicionet e caktuara në kontratë, respektivisht në dokumentacion të tenderit, janë të realizuara në pajtim me standardet cilësi dhe afat të skadencës
1. **Përshkrimi i detyrave të mbikëqyrësve: mbikëqyrësit do të jenë përgjegjës që:**
 - (1) Menaxheri do të kontrollojë kontraktuesin se a i përmbahet kontratës për furnizimin me artikuj ushqimor dhe material higjenik për familjet në nevojë .
 - (2) Kontrollojnë kontraktuesin a i ka përmbajtur kërkesave për furnizimin me artikuj ushqimor dhe material higjenik sipas planit dinamik për furnizim dhe cilësisë së materialit.
 - (3) **Komisioni mbikëqyrës pas pranimit të mallit dhe konstatimit se kontraktuesi e ka përmbush kontratën do të hartojë raport për pranimin e mallit dhe do të dorëzojë te komisioni i cili është i obliguar për hartimin e listave për shpërndarje.**
2. **Mbikëqyrësit kanë edhe këto obligime dhe detyra:**
3. **Mbikëqyrësit kanë edhe këto obligime dhe detyra:**
 - (1) Të sigurojnë korrigjimin e dëmeve eventuale, të shkaktuara gjatë kryerjes së furnizimeve.
 - (2) Të verifikojnë faktorët e pengimit të realizimit të dinamikës gjatë ekzekutimit të furnizimeve.

4. Mbikëqyrësit kanë të drejtë të kërkojnë përmirësime, vazhdimin e furnizimeve, shkëputjen e kontratës apo edhe mohimin e raportit për furnizimet e kryera:

- (1) Nëse ekzekutimi e furnizimeve nuk përmbush standardet e kontraktuara.
- (2) Mbikëqyrësi, me kërkesën e arsyetuar, mund të kërkojë shkëputjen e kontratës pas vërejtjeve mospërfillëse nga kontraktuesi.
- (3) Mbikëqyrësi, duhet të informoj kontraktuesin dhe Departamentin e Prokurimit për çdo vërejtje apo kërkesë gjatë implementimit të kontratës.
- (4) Menaxheri, ka për detyrë të i lëshoj raport për furnizimet e kryera në bazë të kontratës së kontraktuar dhe një kopje të saj e dorëzon në Departamentin e Prokurimit.

5. Mbikëqyrësve nuk u lejohet:

- (1) Të marrin urdhra nga komuniteti, nga kontraktuesi ose përfaqësuesi i tij,
- (2) Të diskutojnë, arsyetojnë e as t'u japin urdhra punëtorëve. Për çfarëdo çështjesh, duhet të bisedojnë me drejtorin e ndërmarrjes ose me përfaqësuesin e tij,
- (3) Për çështjet e lartshënuara, mbikëqyrësit duhet ta kontaktojnë AK, pastaj zyrën e prokurimit, dhe vetëm me pëlqimin e tyre mund të bëjë ndryshimet në ekzekutimin e furnizimeve.

6. Obligimet e raportimit:

- I. Puna e mbikëqyrësve fillon nga momenti i pranimit të vendimit të mbikëqyrjes.
- II. Pas përfundimit të furnizimeve mbikëqyrësit janë të obliguar që t'i dorëzojnë raportin zyrës së prokurimit dhe një kopje të raportit ia dorëzojnë kontraktuesit.
- II. Puna e mbikëqyrësit do të vlerësohet nga organet e Komunës – Lipjan. Pas kalimit të kontratës, shënimet mbi punën e mbikëqyrësve do të ruhen në dosje .
- III. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Departamenti i Prokurimit (organ kontraktues), dhe institucionet tjera komuna që e shfrytëzojnë këtë kontratë
- IV. Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr. _____

Lipjan, _____

Kryetari i Komunës



Imri Ahmeti